

## NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT

### 1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri               Fondi Shqiptar i Zhvillimit  
Adresa           Rruga "Sami Frasheri", nr. 10, Tiranë  
Tel/Faks         +355 4 234885  
E-mail           [prokurimet@albaniandf.org](mailto:prokurimet@albaniandf.org)  
Ueb-faqe        [www.albaniandf.org](http://www.albaniandf.org)

### 2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri               Fondi Shqiptar i Zhvillimit  
E-mail            [prokurimet@albaniandf.org](mailto:prokurimet@albaniandf.org)

### 3. Lloji i procedurës së prokurimit: "E hapur e thjeshtuar"

### 4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes Kuadër: "Kontratë mall"

### 5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: REF-91675-06-29-2026

**6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër:** Paketa e ndërhyrjeve për rigjenerimin urban në Rajonin 2, Loti 1: Ndërhyrje për rigjenerimin urban, mbrojtje detare në zonën bregdetare: Blerje shezllone plazhi, Durrës."

### 7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 39113100-8

**8. Fondi limit :** 7,200,000 lekë pa TVSH. Financimi i këtij objekti është parashikuar në programet buxhetore për periudhën 2026-2028. Programi IVR. Kodi projektit 24AC901.

**9. Justifikimi, argumentat përkatëse dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumentave të tenderit:** Zbatim i pikës 2 të nenit 75 të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar e cila përcakton se: "*Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce*". Në këto kushte behet një ndryshim në dokumentet e tenderit, si dhe shtohet dokumenti Horografia.

**10. Nëse shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave, të shënohet afati i ri i përcaktuar:**  
17/07/2026 ora 11:00

## **SHTOJCË NR.1**

Sot më datë 07.07.2026, Fondi Shqiptar i Zhvillimit ju bën me dije se:

Në zbatim të pikës 2 të nenit 75 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar e cila përcakton se: “Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce”, AK sqaron se pjesë e dokumenteve të tenderit është Horografia b/lidhur shtojces.

Për sa më sipër, ju njoftojmë në dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit me REF-91675-06-29-2026, me objekt: Paketa e ndërhyrjeve për rigjenerimin urban në Rajonin 2, Loti 1: Ndërhyrje për rigjenerimin urban, mbrojtje detare në zonën bregdetare: Blerje shezllone plazhi, Durrës”, **bëhen këtë ndryshime:**

### **I: Në DST në pikën 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar kriteri në pikën 2.2.1:**

#### **Ishte:**

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% vlera e përlogaritur te kontratës ne procedurën e prokurimit.

#### **Bëhet:**

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% vlera e përlogaritur te kontratës ne procedurën e prokurimit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

### **II. Pjesë e Dokumenteve të tenderit shtohet Horografia, b/lidhur kësaj shtojce.**

Afati kohor për dorëzimin e ofertave dhe hapjen e ofertave ndryshon

Ishte: Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 10/07/2026 Ora:11:00

Bëhet: Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 17/07/2026 ora 11:00

Kjo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë Operatorëve ekonomikë në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik duke u bërë detyruese për ta.